



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2020:169885  
Datë: 13.10.2021  
Numri i dokumentit: 02277516

**C.nr. 917/20**

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil** me gjyqtaren Afijete Sada-Gllogjani dhe sekretaren juridike Vjollca Gaxha, duke vendosur në çështjen juridike të paditëses K., kundër të paditurit P.( E.) C. nga Gjakova, rruga "... , për kompensim dëmi material, vlera e kontestit 591.00€, pa shqyrtim të mëtejme me datë 13 tetor 2021, murr këtë;

**A K T G J Y K I M  
PËR SHKAK TË MOSBINDJES**

**APROVOHET** kërkesë-padia e paditëses K. dhe **DETYROHET** i padituri P. (E.) C. nga Gjakova që paditëses të ia paguaj dëmin e shkaktuar material në shumën prej 591.00€ (pesëqind e nëntëdhjetë e një euro) me kamatë ligjore 8% duke filluar nga dita e parashtrimit të padisë (27 nëntor 2020) gjer në pagesën definitive dhe shpenzimet procedurale në shumë prej 20.00 € (njëzet euro) në afat prej 15 ditësh, nën kërcënim të përmbarimit.

**A r s y e t i m**

Paditësja ka parashtruar padi pranë kësaj Gjykate me datë 27 nëntor 2020, kundër të paditurit për kompensimin e dëmit material në shumë 591.01 €. Në referat të padisë është shënuar se i padituri deri me datë 04 prill 2016 me qëllim që vetit ti sjelli pasuri të kundërligjshme ka shfrytëzuar energjinë elektrike në mënyrë të paautorizuar, ashtu që jashtë njëisorit elektrik përmes dy kablove është lidhur direkt në rrjetin elektrik, me këto veprime energjia e shpenzuar nuk është regjistruar. Me atë rast të paditurës i është shkaktuar dëm në shumë prej 591.01€. Shumë e llogaritur në pajtueshmëri me Rregulloren në fuqi "Procedura për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të pa autorizuar të energjisë elektrike" të miratuar nga ZRRE me datë 21 korrik 2009, neni 13 dhe 14.

Sipas Aktgjykimit penal të formës së prerë të Gjykatës Themelore në Gjakovë P.nr. 757/16, datë 03 nëntor 2017, Aktgjykim i plotfuqishëm, i padituri është shpall fajtor, për shkak të kryerjes së veprës penale vjedhje e shërbimeve nga neni 320 të Kodit Penal të Kosovës, përderisa e dëmtuara tani paditësja për kompensimin e dëmit të shkaktuar nga vepra penale është udhëzuar në kontest civil.

Sipas nenit 394 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, Gjykata me aktvendimin C.nr.917/20 të datës 10 dhjetor 2020, ka kërkuar përgjigjen e detyrueshme në padi nga ana e të paditurit.

Nga fletë kthesa në lëndë konstatohet se Aktvendimi për përgjigje në padi i është dorëzuar palës së paditurit me datë 28 dhjetor 2020, i njëjti deri me tani nuk ka dhënë përgjigje në padi.

I padituri brenda afatit të përcaktuar me Ligjin e lartë shënuar nuk i ka paraqitur Gjykatës përgjigje në padi, bazuar në nenin 150.1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, ky Aktgjykim u murr për shkak të pa dëgjueshmërisë përkatësisht mos bindjes, sepse janë plotësuar këto kushte; a) të paditurit padia dhe Aktvendimi për të dhënë përgjigje në padi i është dorëzuar në mënyrë të rregullt, b) themelësia e kërkesëpadisë del nga faktet e parashtruara në padi dhe c) faktet mbi të cilat mbështet kërkesëpadia nuk janë në kundërshtim me provat që i ka propozuar vetë pala paditëse.

Pala e paditur detyrohet të paguajë shpenzimet procedurale për taksë gjyqësore palës paditëse në shumë prej 20.00 € sipas nenit 452 të LPK-së.

Bazuar në nenin 160.6 të njëjtit Ligj janë dhënë arsyet që e arsyetojnë dhënien e këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË**  
**C.nr.917/20, Datë 13 tetor 2021**

**Gj y q t a r j a,**  
**Afijete Sada-Gllogjani**

**UDHËZIM JURIDIK ;** Kundër këtij Aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së tij Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.